



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

N J O F T I M

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komunë, njoftohen qytetarët, shoqatat, grupet e interesit dhe bartësit e institucioneve komunale se me datën **09.05.2016** në ora **14:00** në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit ish ndërtesa e **Bankosit**, do të mbahet:

Dëgjimi Publik

RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

Qëllimi i diskutimit publik është për të krijuar opinione pozitive për projekt-rregulloret në fjalë, të cilat pas zhvillimit të procedurave paraprake ligjore duke përfshirë edhe dëgjimin publik me qytetarë, do të procedohen në Komitetet përkatëse, në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për miratim.

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe grupeve të interesit (OJQ-ve etj) në dëgjim publik për të shprehur mendimet e tyre do të jetë në interes të përgjithshëm.

Projekt-rregulloret mund t'i merreni në Zyrën Ligjore, dhe do të jenë e publikuar edhe në web faqen e komunës: www.kk.rks-gov.net/gjilan

Gjilan, 25 prill 2016

Komuna e Gjilanit